

“Klubi Shumesportesh Apollonia” Sh.a.

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

(te Ushtrimit te mbyllur me date 31.12. 2019)

20 Prill 2020

SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

1. Informacion i përgjithshëm.

Shoqëria “**Klubi Shumesportesh Apollonia**” Sh.a. është regjistruar date 16.04.2018, regjistruar në Drejtorine Rajonale Tatimore Fier, me nipt L82816405H.

Veprimtaria e shoqërise rregullohet sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare” i ndryshuar, nga statuti dhe Legjislacioni ne fuqi.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërise “**Klubi Shumesportesh Apollonia**” Sh.a. është: “Perfaqesimi dhe pjesmarrja ne te gjithë veprimtarine sportive kombetare dhe nderkombetare me te gjitha disiplinat sportive te njohura nga Komiteti Olimpik Kombetar Shqiptar(KOSKH), Komiteti Olimpik Nderkometare,(IOC) dhe te gjitha Federatat Shqiptare Sportive te njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinise sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ligjin nr 79/2017, "Per Sportin". Vazhdimi i tradites sportive, zhvillimin dhe rritjen e cilesis sportive ne te gjitha sportet qe ushtrohen dhe perfaqesojne Bashkine Fier. Krijimin e ekipeve zinxhire te grupmoshave te ndryshme ne sportet e lojrave me dore dhe sportet e renda si basketboll, volejboll, ciklizem, boksi, peshengritja etj. Krijimin e lidhjeve miqesore, shkembimeve te eksperiencave me klubet sportive, shoqatat sportive dhe shoqerite brenda dhe jashte vendit. Manaxhimin, administrimin dhe mirembajtjen e objekteve sportive qe jane ne pronesi te shoqerise Klubi Shumesportesh Apollonia sha. Shoqeria duhet te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregtar qe lidhet ne menyre te drejtperdrejt apo te terthorte me objektin e saj. Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me lejet, autorizimet, licensat sipas legjislacionit ne fuqi”.

Selia e shoqerise eshte ne Lagjen: Lagjia Liri, Rruga Feride Bega, Ndertesa nr. 9, Hyrja 1, Fier.

Shoqeria “**Klubi Shumesportesh Apollonia**” shpk **administrohet** nga administratori i shoqerise z. Palion Zarka, i cili ka kompetenca per drejtimin e saj mbi bazen e statutit.

Shoqeria “**Klubi Shumesportesh Apollonia**” ne muajin mars 2019 ka kaluar nga pergjegjesi tatimore tatim i thjeshtuar mbi fitimin ne tatim fitimi. Per vitin 2019 jane paraqitur dy pasqyra financiare si biznes i vogel deri ne 28.02.2019 dhe si biznes i madh qe perfshin periudhen mars-dhjetor 2019.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Leke, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël


Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

1. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

1.1 Transaksionet në monedhë të huaj.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2019	2018
Euro/LEK	121.77	123.42
USD/LEK	108.64	107.82

1.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

- **Mjetet monetare**

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

- **Llogari të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

- **Llogari të pagueshme**

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

- **Hua të marra dhe të dhëna**

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së maturimit duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

- Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

- Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

- Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

- Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

1.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.


1.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Ndertesa	Vlera e mbetur	5%
Makineri e pajisje	Vlera e mbetur	20 %
Paj, informat	Vlera e mbetur	25%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

1.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

1.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit


Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

1.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

1.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare që mbajtura në vlerë të drejtë



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

1.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

1.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

1.11 Transaksionet me palët e lidhura


Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

1.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

1.13 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha
(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Postet e bilancit paraqiten:

Aktive monetare per 16.064 leke paraqesin mjete monetare ne Banke.

Shoqeria operon me FI banke ne leke, te gjitha veprimet jane rregjistruar ne ditarin perkates, gjendja e saj perputhet me posten e bankes se dates 31.12.2019.

Te tjera te drejta te arketueshme ne shumen 154.994 leke paraqet tatim fitimi te mbipaguar.

Ne llogarine ***Lende te para dhe materiale te tjera*** per 670.152 leke, shoqeria ka paraqitur gjendjen e materialeve dhe inventarit te imet ne date 31.12.2019, gjendje ne magazine dhe ne perdorim. Per inventarin ne perdorim eshte llogaritur konsumi i tij ne masen 50%.

Shpenzime te shtyra ne shumen 960.000 leke jane paraqitur shpenzimet per mirembajtjen e fushes e cila amortizohet per nje periudhe 3 vjecare.

Aktive afatgjata materiale

Shoqeria ka nje vlere neto aktivesh afatgjata per 422.835.274 leke.

Aktivitet jane krijuar nga futja si kontribut ne kapitalin e shoqerise te truallit dhe ndertesave si vijon:

1. Stadiumi i futbollit “Loni Papuçiu”

- Truall 18.592 m² ne vlere 223.215.552 leke
- Ndertime ne vlere 57.720.765 leke

2. Bodrum (bilardo) sipefaqe ne m² 610 ne vlere 24.412.200 leke.

3. Stadiumi i lojrave me dore

- Truall me siperfaqe 4230m² ne vlere 59.363.000 leke.
- Ndertese ne vlere 24.398.860 leke

4. Magazine 2 kate lagja “1 Maji”

- Truall ne m² 700 ne vlere 6.536.600 leke dhe,
- Ndertese ne vlere 37.688.467 leke

Gjate vitit 2019 jane blere nga shoqeria mjete pune ne vlere 49.200 leke dhe blere nga Bashkia 1.180.000 leke tenda per stadiumin.

Eshte llogaritur amortizimi ne shumen 5.855.975 leke, per aam e shtuara gjate 2019 amortizimi ka filluar muajin pasardhes.

Aam jufikohen me inventar fizik te kryer ne fund te ushtrimit.


DETYRIMET DHE KAPITALI

Kapitalet e veta paraqiten me vlere 419.382.185 leke.

Kapitali i nenshkruar i shoqerise eshte 433.335.444 leke te cilat i takojne aksionerit te vetem Bashkise Fier.

Humbje e mbartur ne shumen 5.043.718 leke dhe,

Humbje e vitit 2019 si tatimpagues i biznesit te vogel ne shumen 975.950 leke.



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Humbje ushtrimit sipas bilancit kontabel paraqitet per 7.933.591 leke.

Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet me vlere 5.254.299 leke perfaqesojne:

	<u>31.12.2019</u>	<u>01.03.2019</u>
Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit	2.019.325	185.768
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore	1.995.326	1.110.048
Detyrime tatimore	76.748	101.412
Hua te tjera	1.000	1.000
Te ardhura te shtyra	1.161.900	
Totali	5.254.299	1.398.228

Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit per 2.019.325 leke paraqesin llogarine furnitore per vlerën e faturave të palikujduara, kjo llogari është e analizuar sipas furnitoreve dhe rakordon me llogarinë sintetike të tyre.

Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore paraqitet detyrimin e shoqerise per pagat e punonjesve ne shumen 681.315 leke, pagat e keshillit mbikqyres 52.326 leke, pagat per trajneret me kontrate ne shumen 179.350 leke, pagat per sportistet me kontrate ne shumen 857.000 leke si edhe sigurimet shoqerore per muajin dhjetor 2019 ne shumen 225.335 leke.

Detyrimet tatimore paraqesin:

- **Tatimi mbi te ardhurat** pagat e punonjesve ne shumen 35.864 leke, detyrim per muajin dhjetor 2019 si edhe,
- **Tatim ne burim** per punonjesit me kontrate trajnere dhe anetaret e keshillit te administrimit ne shumen 40.884.

Hua te tjera ne shumen 1.000 leke, paraqet detyrim te shoqerise ndaj te treteve.

Te ardhura te shtyra ne shume 1.161.900 leke paraqet vleren e mbetur te subvencioneve per aam e cila eshte pakesuar me rimarjen ne te njejten mase si edhe aam-ja e subvencionuar.

Verifikimi i llogarise Fitim Humbje

Shpenzimet dhe te ardhurat jane grupuar si me poshte:

Te ardhura

Nga sponsorizimet

Shpenzime te veprimtarise

Materiale te konsumuara

Viti 2018



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Kosto e punes	8.963.038
Pagat e personelit	7.680.400
Shpenzimet per sigurime	1.282.638
Amortizimi	5.855.975
Shpenzime te tjera	11.799.296
Totali i shpenzimeve	27.451.691
Te ardhura te tjera	18.100
Fitim/Humbje bruto	(7.933.591)

Shpenzimet jane 27.451.691 leke ndersa te ardhurat 19.518.100 leke. Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte humbje ne shumen 7.933.591 leke.

Te ardhurat pasqyrojne te ardhura nga sponsorizime nga Bashkia Fier ne shumen 19.500.000 leke dhe rimarja e subverncionit per aam ne masen e amortizimit te aam se subvencionuar ne shumen 18.100 leke.

Shpenzimet ne shumen 27.451.691 leke justifikohen me dokumenta te rregullta fiskale. Me konkretisht shpenzimet sipas zerave paraqiten:

Shpenzime per materiale te konsumueshme 833.382 leke, jane perdorur per veprimtarine kryesore te shoqerise, keto shpenzime jane te justifikuara me dokumenta.


Personeli, ne kete llogari jane pasqyruar shpenzimet per paga 7.680.400 leke, sigurime shoqerore 1.282.638 leke, listepagesat jane perpiluar sakte dhe shpenzimet per paga e sigurime jane vendosur korrekt ne kete llogari. Nje permbledhese e tyre paraqitet :

muajt	paga bruto	paga per efekt kontrib	punedhesi	punemarrasi	sig shend	totali	nr	tatim page
janar								
shkurt								
mars	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,103	17	34,044
prill	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,104	17	34,045
maj	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,105	17	34,046
qershor	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,105	17	34,046
korrik	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,106	17	34,047
gusht	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,107	17	34,048
shtator	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,108	17	34,049
tetor	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,109	17	34,050
nentor	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,109	17	34,050
dhjetor	807,640	807,640	121,146	76,727	27,462	261,199	18	35,864
totali	7,680,400	7,680,400	1,152,060	729,650	261,156	2,485,155	17	342,289

Amortizimi me vlere 5.855.975 leke eshte llogaritur ne baze grupimi, shuma e tij nuk kalon kufijte e fiskut.

Shpenzime te tjera per 11.799.296 leke paraqesin:

- Shpenzime per energji ne shumen 89.400 leke,



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha (Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)

Shpenzimet per sigurime	1.282.638
Amortizimi	5.855.975
Shpenzime te tjera	11.799.296
Totali i shpenzimeve	27.451.691
Te ardhura te tjera	18.100
Fitim/Humbje bruto	(7.933.591)

Shpenzimet jane 27.451.691 leke ndersa te ardhurat 19.518.100 leke. Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte humbje ne shumen 7.933.591 leke.

Te ardhurat pasqyrojne te ardhura nga sponsorizime nga Bashkia Fier ne shumen 19.500.000 leke dhe rimarja e subverncionit per aam ne masen e amortizimit te aam se subvencionuar ne shumen 18.100 leke.

Shpenzimet ne shumen 27.451.691 leke justifikohen me dokumenta te rregullta fiskale. Me konkretisht shpenzimet sipas zerave paraqiten:

Shpenzime per materiale te konsumueshme 833.382 leke, jane perdorur per veprimtarine kryesore te shoqerise, keto shpenzime jane te justifikuara me dokumenta.

Personeli, ne kete llogari jane pasqyruar shpenzimet per paga 7.680.400 leke, sigurime shoqerore 1.282.638 leke, listepagesat jane perpiluar sakte dhe shpenzimet per paga e sigurime jane vendosur korrekt ne kete llogari. Nje permbledhese e tyre paraqitet :

muajt	paga bruto	paga per efekt kontrib	punedhesi	punemarrasi	sig shend	totali	nr	tatim page
janar								
shkurt								
mars	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,103	17	34,044
prill	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,104	17	34,045
maj	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,105	17	34,046
qershor	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,105	17	34,046
korrik	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,106	17	34,047
gusht	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,107	17	34,048
shtator	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,108	17	34,049
tetor	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,109	17	34,050
nentor	763,640	763,640	114,546	72,547	25,966	247,109	17	34,050
dhjetor	807,640	807,640	121,146	76,727	27,462	261,199	18	35,864
totali	7,680,400	7,680,400	1,152,060	729,650	261,156	2,485,155	17	342,289

Amortizimi me vlere 5.855.975 leke eshte llogaritur ne baze grupimi, shuma e tij nuk kalon kufijte e fiskut.

Shpenzime te tjera per 11.799.296 leke paraqesin:

- Shpenzime per energji ne shumen 89.400 leke,
- Shpenzime per konsumin e inventarit te imet ne shumen 163.904 leke,



SHENIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

***“Klubi Shumesportesh Apollonia”sha
(Per ushtrimin e mbyllur ne date 31 Dhjetor 2019)***

- Punonjes te jashtem ne shumen 8.164.650 leke, ketu jane perfshire pagat e trajnereve, sportisteve dhe keshillit te administrimit.
- Shpenzime udhetimi e djeta ne shumen 250.800 leke,
- Shpenzime per internet ne shumen 33.957 leke,
- Shpenzime transporti per sportistet ne shumen 665.885 leke,
- Shpenzime komisione banke per 27.400 leke,
- Shpenzime per rregjistrimin ne federatat ne shumen 408.300 leke,
- Shpenzime sponsorizimi ne shumen 1.500.000 leke,
- Shpenzime per mirembajtjen e fushes 480.000 leke,
- Shpenzime te tjera per 15.000 leke,shpenzime gjoba.

Rezultati ushtrimor neto qe shoqeria ka realizuar nga veprimtaria e saj eshte humbje ne shumen 7.933.591 leke.

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2019 Shoqeria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Pasqyrat financiare jane përgatitur mbi supozimin e biznesit në vijimësi, dhe drejtimi mendon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Administratori

Palion Zarka

